



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 12/2015

Prishtinë, më 24.3.2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje- anëtarë.

Munguan: Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj dhe Sala Berisha-Shala - anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati - ZPRK; Lejla Selimi - OSBE; Dardan Abazi – INDEP; Sylejman Blaku, gazeta “Kosova Sot”; Senada Halimi, gazeta “Zëri” dhe Besa Berisha – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.3.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-09, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike;
4. Çështjet vijuese dhe me prioritet në Planin e punës së Komisionit;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.3.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.3.2015, u miratua me këtë plotësim nga kryetari i Komisionit, z. Muhamet Mustafa, i cili tha se duhet të shtohet ky tekst: *“Kjo është një çështje e rëndësishme se veçantë dhe se kërkon më shumë debat paraprak me aktorët e interesuar, andaj propozoj që mos të merret në konsideratë me këto ndryshime, por të adresohet me ligjin e ri për ndërmarrjet publike”.*

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se pasi që të gjitha komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Raportin me amendamente të Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje substanciale, mirëpo kemi një sugjerim nga Komisioni për Legjislacion për amendamentin 8, ku thotë se duhet të rishikohet referenca, si dhe ka vërejtje të përgjithshme për ndërhyrje në ligjin bazik. Si Komision funksional, do t'i mbrojmë qëndrimet tona në seancën e Kuvendit gjatë leximit të dytë për të gjitha amendamentet e miratuara nga Komisioni.

Fatmir Rexhepi, tha se në qoftë se rekomandimi i Komisionit për Legjislacion në paragrafin e 1 (një), thotë se amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, atëherë kërkoj sqarim pse në paragrafin tjetër thotë se duhet të rishikohet referenca.

Visar Ymeri, Komisioni për Legjislacion ka kërkuar vetëm të rishikohet referenca nga aspekti teknik. Propozoi që amendamenti 8 të riformulohet si vijon:

Amendamenti 8

Neni 9.1 i ligjit bazik, teksti: “me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës”, zëvendësohet me tekstin si vijon: “me 2/3 e të gjithë deputetëve nga Kuvendi i Kosovës”.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, theksoi se nga Komisioni për Integrim Evropian kemi një rekomandim për amendamentet e propozuara, ku thuhet se nga numri 1 (një), deri në 6 (gjashtë), nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ndërsa amendamentet nga numër 7,8,9 dhe 10, të cilat ndryshojnë ligjin bazik, janë në kundërshtim me parimet e hierarkisë së akteve ligjore, si parim bazë i Acquis të BE-së. Mirëpo, ky rekomandim nuk ka ndonjë relevancë, pasi që si Komision funksional, jemi pajtuar me Qeverinë për këto ndërhyrje në ligjin bazik.

Raif Qela, tha se amendamenti 8 duhet të riformulohet në aspektin përmbajtësor. Jam njëri prej atyre që kam qenë krejtësisht i pakënaqur me mënyrën e deritashme të privatizimeve, tha ai. Rezultatet e këtyre privatizimeve flasin. Sidomos kur kemi të bëjmë me çështjet më rëndësi nacionale, është mirë që të kemi konsensus politik. Duhet të kemi një minimum të konsensusit politik edhe në rastin e privatizimit të ndërmarrjeve. Por edhe kriteri 2/3 e votave të anëtarëve të Kuvendit, i domosdoshëm për privatizim të ndërmarrjeve, i cekur në Amendamentin 8, është i lartë dhe duhet të zbutet, sepse si i tillë nuk do të kalojë në votim. Meqenëse teksti i amendamentit 8, si i tillë çfarë është propozuar, konsideron se nuk është formuluar qartë, propozoi që ai të

reformulohet edhe një herë para se të dërgohet ne seance plenare, ashtu që të jetë si vijon: “9.2 Aksione të ndërmarrjeve nga neni 11.3 të këtij Ligji mund të tjetërsohen vetëm pasi që vendimi i miratuar i Qeverisë të jetë votuar nga Kuvendi i Kosovës me 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit”.

Kryetari, tha se duhet të kemi parasysh gjendjen që e kemi edhe kalimi më 81 vota është shumë problem për të arritur në konsensus, por edhe miratimi me shumicën e thjeshtë prej 61 votave, po zëmë me 32 vota për çështjet nacionale nuk është në rregull, prandaj për këtë çështje duhet pak më shumë debate, për të gjetur rrugëdalje dhe kjo më së miri do të bëhet kur ta kemi në shqyrtim ligjin e ri për ndërmarrjet publike.

Pal Lekaj, meqenëse amendamenti 8 është aprovuar nga Komisioni, tani i mbetet Kuvendit a e miraton apo jo, kërkoi që të dërgohet për seancë plenare me këtë ndryshim teknik që iu bë tashmë.

Komisioni, njëzëri, përkrahu ndryshimin teknik sipas propozimit të Komisionit për Legjislacion.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr .05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

2. Raporti t’i procedohet Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.

4. Çështjet vijuese dhe me prioritet në Planin e punës së Komisionit

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se Plani i punës së Komisionit është duke shkuar shumë mirë, në bazë të agjendës për muajt janar dhe shkurt është realizuar, ndërsa në fillim të muajit mars kemi të paraparë nismën legjislative për Projektligjin për sigurinë në punë në miniera, të cilën nismë e ka propozuar deputetja znj. Sala Berisha-Shala, por që ende nuk ka filluar këtë nismë dhe kërkoi që kjo punë të fillojë sa më shpejt. Po ashtu, për këtë muaj është paraparë edhe vizita tek bizneset vendore, mirëpo këtë e ka bërë grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja dhe po ashtu kemi paraparë vizita mbikëqyrëse tek ndonjë nga ndërmarrjet publike.

Visar Ymeri, propozoi që të vizitohet KEK-u, që të takohen me menaxhmentin dhe Bordin e KEK- ut, si dhe vizita në terren në termocentralin “Kosova B”.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, pajtohet me propozimin e z.Ymeri dhe propozoi që të shkojnë një grupi i anëtarëve të Komisionit me këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit, Visar Ymeri, Raif Qela, Fatmir Rexhepi dhe Duda Balje – anëtarë, mirëpo mund t’i bashkohen edhe deputetët tjerë. Lidhur me këtë vizitë mbikëqyrëse, kërkoi që në agjendën e vizitës të jenë këto pika për KEK-un: të informohemi për gjendjen e prodhimit, gjendjen e investimeve, funksionimin dhe qeverisjen korporative, si dhe relacionet me ministrinë përkatëse dhe Kuvendin. Propozoi që vizita të realizohet të martën, më 31 mars, në ora 14:00.

Me propozimin u pajtuan anëtarët e Komisionit.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se ka qenë një konkluzion nga mbledhjet e kaluara, që të kemi një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Legjislacion dhe Këshillin

Gjyqësor të Kosovës dhe të kërkojë informatë nga odat ekonomike në Kosovë dhe asociacionet e bizneseve, për sfidat që po ju paraqiten lidhur me kontestet gjyqësore që kanë bizneset dhe investitorët.

Pal Lekaj, tha se grupi i punës për mbikëqyrjen e Ligjit për investimet e huaja, gjatë takimeve që ka pasur me odat ekonomike në Kosovë, iu janë paraqitur këto probleme që kanë me kontestet gjyqësore nëpër gjykata. Ai tha se për këtë pajtohem me kryetarin e Komisionit, z. Mustafa që të jetë një takimi i përbashkët me Komisionin për Legjislacion, ku do të ftohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për të raportuar mbi kërkesat e kontesteve gjyqësore që kanë bizneset dhe investitorët e huaj.

Blerim Grainca, lidhur me këtë tha se në Planin e punës së Komisionit është paraparë të ketë diskutim për sfidat e bizneseve nga vizitat në terren dhe rekomandimi i hapave të nevojshëm për përmirësimin e të bërit biznes.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për këtë çështje do të konsultohet edhe me kryetaren e Komisionit për Legjislacion, znj. Albulena Haxhiun dhe propozoi që për problemet që po u paraqiten bizneseve dhe investitorëve, të hartohet një plan pune, ku do të ftohen për konsultim edhe asociacionet e bizneseve dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pastaj t'i nxjerrim disa rekomandime për funksionimin dhe përmirësimin e mjedisit biznesor, në raport me sundimin e rendit dhe ligjit.

Visar Ymeri, kërkoi që para se të realizohet ky takimi i propozuar, fillimisht kërkohet informatë nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se cili është numri i kontesteve gjyqësore.

Me propozimin u pajtuan anëtarët e Komisionit.

4. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa